



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA BELSH

KESHILLI BASHKIAK BELSH

Nr ____ Prot

Belsh më ____/____/ 2024

PROCES-VERBAL

I mbledhjes së këshillit bashkiak të datës 23.04.2024 me 15 këshilltarë prezentë, në mbështetje të ligjit 139/2015 për vetëqeverisjen vendore. Njoftimi i këshilltarëve u bë nga sekretari i këshillit bashkiak dhe materialet e diskutuara janë dërguar nëpërmjet formatit elektronik.

Janë prezent në mbledhje 15 këshilltarë:

1. Erjon Qafa
2. Nexhip Elezi
3. Bujar Blloku
4. Aurela Hysa
5. Blerim Kuqja
6. Nertila Uruci
7. Naime Ibrahimimi
8. Sami Uruci
9. Kujtim Dervishi
10. Gezim Gjoshi
11. Ismail Paja
12. Fadil Zdrava
13. Gazeli Hysa
14. Erion Gjoshi
15. Libeta Dragoti

-Kryetari i keshillit bashkiak hap mbledhjen e keshillit.

-Diskutohet rendi i dites. Diskuton N.Uruci ne lidhje me rendin e dites dhe per mbledhjet e komisioneve te keshillit.

-Hidhet në votim rendi i ditës dhe miratohet me 11 vota pro.

- Diskutohet proces verbali i mbledhjes së kaluar nga ana e këshilltarëve.
- Kalohet për diskutim në pikën 3 të rendit të ditës për ndihmën ekonomike.Mbron përgjegjësja e zyrës E.Dervishi. Hidhet në votim Ndhma ekonomike dhe miratohet me 14 vota pro.
- Diskutohet pika nr.4 e rendit të ditës për Programin e transparencës në Bashkinë Belsh. Mbron Fatmira Broshka,punonjëja e zyrës për informimin publik. Diskuton E.Gjoshi në lidhje me kërkesat dhe përgjigjet ndaj qytetarëve.
- Hidhet në votim pika 4 dhe miratohet me 12 vota pro dhe 2 abstenim.
- Kalojmë në pikën 5 të rendit të ditës ,në lidhje me projekt vendimin për dhënien në përdorim të fondit pyjor /Kullosor. Diskuton N.Uruci,nëse është bërë dëgjese publike nga ana e Bashkisë me banorët. Përgjigjet A.Dervishi që dëgjuesën publike duhet ta organizojë këshilli bashkiak.
- Diskuton E .Gjoshi që të interesuarit të sjellin një shpjegim për arsyet që nuk duan që këto prona të jepen me qera.
- N.Uruci i drejtohet sekretarit të këshillit që të merret me organizimin e dëgjësës sipas ligjit.
- Diskuton kryetari i këshillit që ky projekt vendim të kalojë për dëgjese publike pastaj të vijë në këshill bashkiak.
- Kalojmë te pika informacion nga Tatim Taksat
- Ditjon Pepa: Cdo gjë është sipas projekt vendimit që ka kaluar mbi taksat dhe tarifat .
- B.Kuqja: U tha gjatë diskutimit të taksave dhe tarifave që do të ketë rritje për 10 biznese.
- D.Pepa: Materiali për taksat dhe tarifat ju ka shkuar përpara këshilltarëve për të parë rritjen e taksave dhe tarifave.
- Diskutohet kërkesa e Adelina Dervishit. Propozon N.Uruci që kjo kërkesë të merret me seriozitet dhe nëse është e mundur të ndihmohet kjo familje. Kreytari i këshillit vendos që të ja kalojë përsëri zyrës për verifikim.
- Diskutohet në lidhje me komisionet nga kryetarët e grupeve,se si do të funksionojnë. Diskuton E.Gjoshi që në pamundësi për të qënë fizikisht ,mbledhja e komisioneve të bëhet edhe online.

-Diskuton I.Paja që të merret më me seriozitet zgjedhja e kryetarëve të fshatrave dhe procesi që këshilli ka filluar.

-E Gjoshi: Jap dorëheqjen nga komisioni i Ekonomisë dhe propozoj si zëvendësues z.Sami Uruci. Hidhet në votim dhe miratohet me 13 vota pro.

-N.Uruci : Kërkojmë informacion në mbledhjen e ardhshme për gjëndjen e shkollave dhe nr e Nxënësve,bashkë me numrin e mesuesve dhe edukatoreve në Bashkinë Belsh.

-B.Kuqja ; Kërkojmë informacion nga zyra e urbanistikes për terrenet sportive dhe kufizimet e tyre.

Mbyllet mbledhja e këshillit me 3 vendime të miratuara.

Përgatiti :

SEKRETARI I KËSHILLIT

Endri PEPA